

VENDIM
Nr.163, datë 21.3.2006

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË “ISH-SPITALIT TË
KFOR-IT, DURRËS, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E
DREJTËSISË, PËR SISTEMIMIN DHE AKOMODIMIN E KONTINGJENTIT TË TË
SËMURËVE ME MJEKIM TË DETYRUAR, ME VENDIM GJYKATE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të “Ish-spitalit të KFOR-it, Durrës”, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Drejtësisë, për sistemimin dhe akomodimin e kontingjentit të të sëmurëve me mjekim të detyruar, me vendim gjykate, dhe kontingjentit të të paraburgosurve të qarkut të Durrësit, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve, pronën e përcaktuar në këtë vendim.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

GEN PLANI

PLANI PIKETIMIT RRJETI RRUGOR sh1500


FOND
PROJE

1

PROJETI

ESECUT.

COLABOR



SHENIM

imi i objektit niset nga dy objektet egzistuese
a e lonsionit të lartë që shtrihet me SHYLLA BEIONI
ton Veriore të rrethimit në distancë 42 M. dhe
usin A-A të objektit në distancë 42 M.
a pika (X) (Kryezimi i zgjatimit të faqes së rruges
gjen në plan) Distancat e pikës (X) janë nga rrethimi
a aksi 20-24 166 M. Distancat pariale të rrugëve të
anë në projekt.

KUOTAT E OBJEKTIT TI
REFEROHEN PIKES (B) +120

156 M
ASFALETOBETON 5cm
ÇAKULLIRULUAR 15cm
ZHAVOR, LUMI 30cm

PRERJA RRUGES sh150

